



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e jashtëzakonshme, të mbajtur më 6.05.2016, merr këtë

V E N D I M

Neni 1

Miratohet Vendimi për lejimin e afatit shtesë Agjencisë Kosovare të Privatizimit për lirimin e hapësirave, të cilat i janë dhënë me qira në bazë të kontratës 01. nr. 046-50871/1.

Neni 2

Afati shtesë i cekur në nenin 1 të këtij vendimi, përfundon më 31.5.2016.

Neni 3

Për periudhën shtesë nga 1.2.2016 deri më 31.5.2016, Agjencia obligohet që të vazhdojë të paguajë qiranë në pajtim me kushtet e përcaktuara në nenin 7, shtojca A e kontratës.

Neni 4

Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me aneks-kontratë, të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të autorizuar të Agjencisë.

Neni 5


Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Pronës.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr.046-112186, më 11.05.2016



KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi, jur. i dipl

A r s y e t i m

Kontrata 01. nr. 046-50871/1, e nënshkruar në mes të Komunës së Prishtinës, si qiradhënës, dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit, si qiramarrës, ka skaduar më 31.1.2016. Mirëpo, Agjencia Kosovare e Privatizimit ka dështuar të lirojë hapësirën e dhënë me qira brenda afatit të përcaktuar. Si pasojë e kësaj gjendjeje të krijuar, Komuna e Prishtinës dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit, në pajtim me nenin 14, shtojca A e kontratës, kanë zhvilluar negociata për zgjidhjen e këtij problemi.

Komuna dhe Agjencia në parim janë pajtuar që Agjencisë t'i jepet një afat shtesë, deri më 31.5.2016, për lirim të hapësirave. Gjithashtu, Agjencia është pajtuar që gjatë afatit shtesë të vazhdojë t'i paguajë Komunës qiranë në pajtim me kushtet e përcaktuara në nenin 7, shtojcës A e kontratës.

Andaj, duke marrë parasysh rrethanat e cekura më lart, faktin që afati shtesë i kërkuar është i shkurtër dhe që Komuna do të vazhdojë të marrë qira edhe gjatë afatit shtesë; si dhe duke marrë parasysh që ndërmarrja e masave ligjore për largim të pavullnetshëm të qiramarrësit kërkon kohë të gjatë dhe ka kosto financiare, i propozoj Kuvendit të Komunës miratimin e këtij vendimi.